

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON PRIVATIZATION AGENCY OF KOSOVO RELATED MATTERS	POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODMOSE NA KOSOVSKU AGENCIJU ZA PRIVATIZACIJU
--	---	--

SCEL – 11-0022

Ankuesit

Punëtorët e NSH XX, XX

C1. D.S., XX

C2. J.Š., XX

C3/1. M.S., XX

Përfaqësuar nga avokati XX, XX

C3/2. N.S., XX

Përfaqësuar nga avokati XX, XX

C3/3. M.P., XX

Përfaqësuar nga avokati XX, XX

C3/4. S.N., XX

Përfaqësuar nga avokati XX, XX

C3/5. B.S., XX

Përfaqësuar nga avokati XX, XX

C3/6. M.S., XX

Përfaqësuar nga avokati XX, XX

C4. D.S., XX

C5. I.L., XX

C6. K.J.A., XX

C7. M.D.J., XX

C8. M.M., XX

C9. N.M., XX

C10. R.H., XX

C11. Z.S., XX

Kundër

E Paditura

Agjencia Kosovare të Privatizimit (AKP)

Rruga Ilir Konushevcit nr 8, Prishtinë

Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Trupi Gjyqësor, i përbërë nga Alfred Graf von Keyserlingk, Gjyqtar Kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Çerim Fazliji, Gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 22 shkurt 2013, lëshon këtë

AKTGJYKIM

1. Ankesat e Đ.S.(C1), J.Š.(C2), M.S.(C3/1), N.S.(C3/2), M.P.(C3/3), S.N.(C3/4), B.S.(C3/5), M.S.(C3/6), D.S.(C4), I.L.(C5), K.J.A.(C6), M.D.J.(C7), M.M.(C8), N.M.(C9), R.H.(C10), Z.S.(C11) janë të bazuara.
2. Këta ankues duhet të përfshihen në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejta legjitime për pjesëmarrje nga përfitimet e privatizimit të NSH XX, XX.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Ankuesit janë ish-punëtorë të Ndërmarrjes Shoqërore XX, XX (NSH) veprimtaria thelbësore e të cilës ka qenë trajnimi i kandidatëve në testet për patentë shofer.

Më 30. 6. 1999, kur shumica e punëtorëve janë larguar nga vendet e tyre të punës ajo ka lëshuar një vendim duke i ftuar të gjithë punëtorët që të paraqiten në punë brenda 60 ditëve. Me 1.9. 1999, ajo ka lëshuar një vendim “mbi ndërprerjen e punës” për 37 punëtorë për shkak të mungesës në punë. Punëtorët ishin radhitur në listë me emra. Në këtë listë po ashtu shihen edhe emrat e Paditësve C3/2, C3/6, C6 DHE C7. Lista ishte shpallur në tabelën e shpalljeve të ndërmarrjes.

NSH-ja më vonë ishte privatizuar përmes një Spin Off-i të zakonshëm nga e Paditura. Kontrata e shitjes është ratifikuar me ofertuesin fitues me 27.12. 2006.

Lista e përkohshme e punëtorëve me të drejta legjitime ishte shpallur me 18.07.2009, dhe se afati i fundit për parashtrimin e ankesave në AKP ka qenë 08.08. 2009.

Lista përfundimtare është shpallur me 7, 8, dhe 10 prill 2011 me afat të fundit për paraqitjen e ankesave në Dhomën e Posaçme, 30 prill 2011.

Me 22 prill 2011, Đ.S.(**ankuesi C1**) ka paraqitur ankesë duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfituar pjesën prej 20 për qind nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së që ishte shpallur në “Danas” me 5 prill 2011. Ankuesi ka punuar në NSH prej 1 mars 1975 deri në qershor 1999. Ai thekson se nuk ka mundur të shkojë në punë pas qershorit 1999 sepse është dashur të largohet nga Gjilani për shkak të gjendjes kërcënuese për jetë. Ai ankohet se është diskriminuar ngase i përkiste etnisë Serbe. Ai e ka dërguar një kopje të librezës së punës.

Në vërejtjet me shkrim të datës 26 maj 2011, e Paditura arsyeton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse ankuesi nuk ka paraqitur ankesë në Agjenci kundër listës së përkohshme të punëtorëve. E Paditura arsyeton se ankuesi nuk i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet administrative për ankesë para se ti drejtohet gjykatës ashtu siç kërkohet me Nenin 127.4 të Ligjit mbi Procedurën Administrative 02/L-28.

Me 22 prill 2011, J.Š. (**ankuesja C2**) ka paraqitur ankesë duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfituar pjesën prej 20 për qind e të ardhurave nga privatizimit i NSH-së që ishte shpallur në “Danas” me 5 prill 2011. Ankuesja ka punuar në NSH prej 7 tetor 1986 deri në qershor 1999. Ajo thekson se nuk

ka mundur të shkojë në punë pas qershorit 199 sepse është dashur të largohet nga Gjilani për shkak të gjendjes kërcënuese për jetë. Ajo ankohet se është diskriminuar ngase i përkiste etnisë Serbe. Ajo ka cekur se kur e kishte marrë librezën e punës nga NSH-ja, punësimi i saj ishte ndërprerë me 30 qershor 2003. Ajo e ka dërguar një kopje të librezës së punës.

Në vërejtjet me shkrim të datës 26 maj 2011, e Paditura arsyeton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse ankuesja nuk ka paraqitur ankesë në Agjenci kundër listës së përkohshme të punëtorëve. E Paditura argumenton se ankuesja nuk i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet administrative për ankesë para se ti drejtohet gjykatës ashtu siç kërkohet me Nenin 127.4 të Ligjit mbi Procedurën Administrative 02/L-28.

Me 23 prill 2011, M.S. (**ankuesi C3/1**) ka paraqitur ankesë duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfitur pjesën prej 20 për qind nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesi ka cekur se vendimi i të Paditurës i datës 26 janar 2011 me të cilin refuzohet ankesa e tij në bazë të mbylljes së librezës së tij të punës dhe se ai nuk ka qenë i punësuar në NSH në kohën e privatizimit nuk është i bazuar. Ankuesi ka cekur se nuk ka mundur ta vazhdojë punën në NSH për shkak të rrethanave të pas luftës. Pastaj, atij iu ka dashur që të punoi çfarëdo pune për ta mbajtur familjen. Ka cekur se ai dhe punëtorët tjerë kanë pritur që situata të normalizohet dhe se kanë qenë të interesuar të kthehen në punë. Mirëpo, ata kurrë më nuk janë ftuar në punë dhe se atyre iu është dorëzuar një vendim mbi shkëputjen e punësimit të tyre.

Në vërejtjet me shkrim të datës 31 maj 2011, e Paditura arsyeton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse ankuesi nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për të qenë në listë. E Paditura parashtron se deklarata mbi diskriminimin është e pabazuar sepse nuk është materializuar me prova. Pastaj, se librezat e tij e punës është mbyllur dhe se punësimi i tij është ndërprerë me 01. 09. 1999. E Paditura i referohet një Deklarate të Drejtorit të NSH-së se ankuesi ka qenë i punësuar në NSH deri me 01.09. 1999 kur iu ka ndërprerë punësimi në bazë të asaj që ai nuk iu ka përgjigjur ftesës për tu kthyer në punë brenda tre muajve. E Paditura ka dërguar një Vendim mbi rrimërimin e të gjithë punëtorëve nga viti 1999 dhe Vendimin mbi shkëputjen e punësimit nga viti 1999. E Paditura tregon se Ankuesi nuk ka qenë në listën e pagave apo i regjistruar në NSH në kohën e privatizimit.

Me 23 prill 2011, N.S. (**ankuesi C3/2**) ka paraqitur ankesë duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfitur pjesën prej 20 për qind nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesi ka cekur se vendimi i të Paditurës i datës 26 janar 2011 me të cilin refuzohet ankesa e tij në bazë të mbylljes së librezës së tij të punës dhe se ai nuk ka qenë i punësuar në NSH në kohën e privatizimit nuk është i bazuar. Ankuesi ka cekur se nuk ka mundur ta vazhdojë punën në NSH për shkak të rrethanave të pas luftës. Pastaj, atij iu ka dashur që të punoi çfarëdo pune për ta mbajtur familjen. Ka cekur se ai dhe punëtorët tjerë kanë pritur që situata të normalizohet dhe se kanë qenë të interesuar të kthehen në punë. Mirëpo, ata kurrë më nuk janë ftuar në punë dhe se atyre iu është dorëzuar një vendim mbi shkëputjen e punësimit të tyre.

Në vërejtjet me shkrim të datës 31 maj 2011, e Paditura arsyeton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse ankuesi nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për të qenë në listë. E Paditura parashtroi se deklarata mbi diskriminimin është e pabazuar sepse nuk është materializuar me prova. Pastaj, se librezja e tij e punës është mbyllur dhe se punësimi i tij është ndërprerë me 01. 09. 1999. E Paditura i referohet një Deklarate të Drejtorit të NSH-së se ankuesi ka qenë i punësuar në NSH deri me 01.09.1999 kur iu ka ndërprerë punësimi në bazë të asaj që ai nuk iu ka përgjigjur ftesës për tu kthyer në punë brenda tre muajve. E Paditura ka dërguar një Vendim mbi rrimërimin e të gjithë punëtorëve nga viti 1999 dhe Vendimin mbi shkëputjen e punësimit nga viti 1999. E Paditura tregon se Ankuesi nuk ka qenë në listën e pagave apo i regjistruar në NSH në kohën e privatizimit.

Me 23 prill 2011, M.P. (**ankuesi C3/3**) ka paraqitur ankesë duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfitur pjesën prej 20 për qind nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesi ka cekur se Vendimi i të Paditurës i datës 26 janar 2011 me të cilin refuzohet ankesa e tij në bazë se punësimi i tij i është ndërprerë përdërisa librezën e kishte të hapur është i pabazuar. Ankuesi ka cekur se nuk ka qenë faj i tij pse iu ka ndërprerë punësimi njëanshëm dhe se nuk ka qenë i informuar për këtë. Ankuesi ka cekur se ka qenë i diskriminuar nga e Paditura sepse ai ka të drejtë të përfshihet në listë dhe se ai nuk është trajtuar drejtë nga drejtuesit e NSH-së.

Në vërejtjet me shkrim të datës 31 maj 2011, e Paditura parashtroi se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse ankuesi nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për të qenë në listë. E Paditura parashtroi se deklarata mbi diskriminimin është e pabazuar sepse nuk është materializuar me prova. E Paditura ka cekur se përdërisa librezja e ankuesit është e hapur ai nuk ka prezantuar prova se është përpjekur që ta ri-themelojë marrëdhënien e punësimit pas vitit 1999. E Paditura parashtroi se Ankuesi nuk ka qenë në listën e pagave apo i regjistruar në NSH në kohën e privatizimit.

Me 23 prill 2011, S.N. (**ankuesi C3/4**) ka paraqitur ankesë duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfitur pjesën prej 20 për qind nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesi ka cekur se Vendimi i të Paditurës i datës 26 janar 2011 me të cilin refuzohet ankesa e tij në bazë të asaj që ai kishte filluar punësim të ri është i pabazuar. Ai ka cekur se e Paditura ka gabuar në vërtetimin e fakteve; ai është regjistruar për përfitime sociale pasi që nuk ka pasur të ardhura, çka nuk do të thotë se ai ka filluar punë të re. Andaj, vendimi i të Paditurës me të cilin refuzohet kërkesa për pjesën prej 20 % nuk është i bazuar.

Në vërejtjet me shkrim të datës 31 maj 2011, e Paditura arsyeton se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse ankuesi nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për të qenë në listë. E Paditura parashtroi se deklarata mbi diskriminimin është e pabazuar sepse nuk është materializuar me prova. E Paditura ka cekur se përdërisa librezja e ankuesit ka qenë e hapur marrëdhënia e tij e punësimit kishte përfunduar që nga 01.09. 1999. E Paditura i referohet një Deklarate të Drejtorit të NSH-së se ankuesi ka qenë i punësuar në NSH deri me 01.09. 1999 kur iu ka ndërprerë punësimi në bazë të asaj që ai nuk iu ka përgjigjur ftesës për tu kthyer në punë brenda tre muajve. E Paditura ka dërguar një

Vendim mbi rrimërimin e të gjithë punëtorëve nga viti 1999 dhe Vendimin mbi shkëputjen e punësimit nga viti 1999. E Paditura tregon se Ankuesi nuk ka qenë në listën e pagave apo i regjistruar në NSH në kohën e privatizimit.

Me 23 prill 2011, B.S. (**ankuesi C3/5**) ka paraqitur ankesë duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfituar pjesën prej 20 për qind nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesi ka cekur se Vendimi i të Paditurës i datës 26 janar 2011 me të cilin refuzohet ankesa e tij në bazë të asaj që ai kishte filluar punësim të ri është i pabazuar. Ai ka cekur se e Paditura ka gabuar në vërtetimin e fakteve; ai është regjistruar për përfitime sociale pasi që nuk ka pasur të ardhura, çka nuk do të thotë se ai ka filluar punë të re. Andaj, vendimi i të Paditurës me të cilin refuzohet kërkesa për pjesën prej 20 % nuk është i bazuar.

Në vërejtjet me shkrim të datës 31 maj 2011, e Paditura tregon se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse ankuesi nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për të qenë në listë. E Paditura parashton se deklarata mbi diskriminimin është e pabazuar sepse nuk është materializuar me prova. E Paditura ka cekur se përderisa librezat e ankuesit është hapur marrëdhënia e tij e punësimit kishte përfunduar që nga 01.09. 1999.. E Paditura i referohet një Deklarate të Drejtorit të NSH-së se ankuesi ka qenë i punësuar në NSH deri me 01.09. 1999 kur iu ka ndërprerë punësimi në bazë të asaj që ai nuk iu ka përgjigjur ftesës për tu kthyer në punë brenda tre muajve. E Paditura ka dërguar Vendimin mbi rrimërimin e të gjithë punëtorëve nga viti 1999 dhe Vendimin mbi shkëputjen e punësimit nga viti 1999. E Paditura tregon se Ankuesi nuk ka qenë në listën e pagave apo i regjistruar në NSH në kohën e privatizimit.

Me 23 prill 2011, M.S. (**ankuesi C3/6**) ka paraqitur ankesë duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfituar pjesën prej 20 për qind nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesi kundërshton vendimin e të Paditurës me të cilin refuzohet ankesa e tij në bazë të asaj që nuk ka prova për ta mbështetur ankesën e tij. Ankuesi thotë se kjo është e pabazuar sepse librezat e tij e punësimit ka humbur në NSH, por punësimi i tij mund të vërtetohet nga dokumentet tjera që gjenden në NSH. Ai i dërgon dy vendime për pushim vjetor, të cilat janë të vetmet dokumente që i posedon.

Në vërejtjet me shkrim të datës 31 maj 2011, e Paditura tregon se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse ankuesi nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për të qenë në listë. E Paditura parashton se deklarata mbi diskriminimin është e pabazuar sepse nuk është materializuar me prova. E Paditura ka cekur se përderisa librezat e ankuesit është hapur marrëdhënia e tij e punësimit kishte përfunduar që nga 01.09. 1999.. E Paditura i referohet një Deklarate të Drejtorit të NSH-së se ankuesi ka qenë i punësuar në NSH deri me 01.09. 1999 kur iu ka ndërprerë punësimi në bazë të asaj që ai nuk iu ka përgjigjur ftesës për tu kthyer në punë brenda tre muajve. E Paditura ka dërguar një Vendim mbi rrimërimin e të gjithë punëtorëve nga viti 1999 dhe Vendimin mbi shkëputjen e punësimit nga viti 1999. E Paditura tregon se Ankuesi nuk ka qenë në listën e pagave apo i regjistruar në NSH në kohën e privatizimit.

Me 24 prill 2011, D.S. (**ankuesi C4**) ka paraqitur ankesë duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfitur pjesën prej 20 për qind nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesi ka cekur se Vendimi i të Paditurës i datës 26 janar 2011 me të cilin refuzohet ankesa e tij është i pabazuar, sepse ai ka vërtetuar se ka punuar në NSH për shumë vite dhe se librezat e tij është hapur me NSH-në. Ai ka cekur se ka qenë gjithnjë i angazhuar në aktivitetet e NSH-së edhe pse nuk ka pasur punë për te. Ai thotë se nuk ka marrë vendim mbi ndërprerjen e punësimit andaj edhe nuk është e drejtë që e Paditura e ka refuzuar kërkesën e tij në bazë të shënimeve të NSH-së mbi punësimin. Ai ka cekur se ka qenë në listën e pagave në vitin 2001. Kërkon nga DHPGJS që ta caktojë një seancë dëgjimore.

Në vërejtjet me shkrim të datës 31 maj 2011, e Paditura tregon se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse ankuesi nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për të qenë në listë. E Paditura thekson se sipas shënimeve të librit amzë të NSH-së dhe deklaratës së Drejtorit të NSH-së se ankuesi ka qenë i punësuar në NSH prej 01.07.1999 deri me 15.08.2000 kur iu ka ndërprerë punësimi në bazë të asaj që ai kishte filluar një punë të re. E Paditura ka cekur se Ankuesi nuk ka prezantuar dokumente tjera në mbështetje të kërkesës së tij.

Me 29 prill 2011, I.L. (**ankuesi C5**) ka paraqitur ankesë duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfitur pjesën prej 20 për qind nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesi ka cekur se Vendimi i të Paditurës i datës 26 janar 2011 me të cilin refuzohet ankesa e tij është i pabazuar. Ai ka cekur se e Paditura ka gabuar në vërtetimin e fakteve, sepse ai kishte punuar në NSH për shumë vite dhe se është kthyer në punë pas vitit 1999 dhe ka vazhduar të punoi me vite. Ka cekur se është i angazhuar gjithnjë në aktivitetet e NSH-së edhe pse nuk ka pasur punë për te. Ai thotë se nuk ka marrë vendim mbi ndërprerjen e punësimit andaj edhe nuk është e drejtë që e Paditura e ka refuzuar kërkesën e tij në bazë të shënimeve të NSH-së mbi punësimin. Ai ka cekur se ka qenë në listën e pagave në vitin 2001. Kërkon nga DHPGJS që ta caktojë një seancë dëgjimore.

Në vërejtjet me shkrim të datës 31 maj 2011, e Paditura tregon se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse ankuesi nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për të qenë në listë. E Paditura thekson se sipas shënimeve të librit amzë të NSH-së dhe deklaratës së Drejtorit të NSH-së se ankuesi ka qenë i punësuar në NSH prej 01.07.1999 deri me 15.08.2000 kur iu ka ndërprerë punësimi në bazë të asaj që ai kishte filluar një punë të re. E Paditura ka cekur se Ankuesi nuk ka prezantuar dokumente tjera në mbështetje të kërkesës së tij.

Me 29 prill 2011, K.J.A. (**ankuesi C6**) ka paraqitur ankesë duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfitur pjesën prej 20 për qind nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesi ka cekur se vendimi i të Paditurës me të cilin refuzohet ankesa e tij është i pabazuar, sepse ai ka vërtetuar se ka punuar në NSH për shumë vite, se librezat e tij e punës është ende hapur dhe se nga shënimet e NSH-së nuk shihet ndërprerja e punësimit, prapëseprapë kërkesa e tij ishte refuzuar. Ai ka cekur se kishte punuar në NSH para luftës dhe se është kthyer në punë pas vitit 1999. Mirëpo, nuk

ka qenë e sigurt për te që të mbetet në Kosovë pas vitit 1999 sepse ishte kërcënuar dhe i është dashur të largohet. Ai ka cekur se nuk ka njohuri se si janë mbajtur shënimet e punësimit në NSH pasi që ai e ka lënë ndërmarrjen. Ai kërkon nga DHPGJS që ta caktojë një seancë dëgjimore.

Në vërejtjet me shkrim të datës 31 maj 2011, e Paditura tregon se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse ankuesi nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për të qenë në listë. E Paditura thekson se librezja e punës që është dërguar nga Ankuesi nuk është dëshmi e mjaftueshme dhe se Ankuesi nuk ka dërguar prova se ka ri-themeluar marrëdhënie punësimi pas vitit 1999 dhe se ajo ka kërkuar siguri nga UNMIK-u apo KFOR-i. E Paditura ka cekur se sipas Vendimit të NSH-së të datës 01.09. 1999 punësimi i tij është ndërprerë për shkak të mungesës nga puna për më shumë se 60 ditë.

Me 29 prill 2011, M.D.J. (**ankuesi C7**) ka paraqitur ankesë duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfitur pjesën prej 20 për qind nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesi ka cekur se vendimi i të Paditurës me të cilin refuzohet ankesa e tij është i pabazuar, sepse ai është bazuar në faktin se librezja e tij e punës është mbyllur. Ai ka cekur se përderisa punësimi i tij ishte ndërprerë në vitin 1998 ai është kthyer në punë në vitin 1999 së bashku me të gjithë punëtorët tjerë. Mirëpo, nuk ka qenë e sigurt për te që të mbetet në Kosovë pas vitit 1999 sepse ishte kërcënuar dhe i është dashur të largohet. Ai ka cekur se nuk ka njohuri se si janë mbajtur shënimet e punësimit në NSH pasi që ai e ka lënë ndërmarrjen. Ai kërkon nga DHPGJS që ta caktojë një seancë dëgjimore.

Në vërejtjet me shkrim të datës 31 maj 2011, e Paditura tregon se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse ankuesi nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për të qenë në listë. E Paditura thekson se librezja e punës që është dërguar nga Ankuesi është mbyllur që në vitin 1998, andaj ankuesi nuk ka qenë në listën e pagave apo i punësuar në NSH në kohën e privatizimit.

Me 29 prill 2011, M.M. (**ankuesja C8**) ka paraqitur ankesë duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfitur pjesën prej 20 për qind nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesja ka cekur se vendimi i të Paditurës me të cilin refuzohet ankesa e saj është i pabazuar, sepse ajo ka vërtetuar se ka punuar në NSH, se librezja e saj është e hapur dhe se ajo është kthyer në punë pas vitit 1999. Ka cekur se nuk ka marrë vendim mbi ndërprerjen e punësimit të saj andaj edhe është e padrejtë që e Paditura e ka refuzuar kërkesën e saj në bazë të shënimeve NSH-së mbi punësimin. Ajo ka cekur se ka qenë gjithnjë e angazhuar në aktivitetet e NSH-së edhe pse nuk ka pasur punë për te. Kërkon nga DHPGJS që ta caktojë një seancë dëgjimore.

Në vërejtjet me shkrim të datës 31 maj 2011, e Paditura tregon se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse ankuesi nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për të qenë në listë. E Paditura thekson se ankuesja nuk ka dërguar prova të mjaftueshme. Ajo i referohet deklaratës së Drejtorit të NSH-së se punësimi i saj është ndërprerë me 16.08. 200 sepse kishte filluar një punë të re.

Me 29 prill 2011, N.M. (**ankuesi C9**) ka paraqitur ankesë duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfitur pjesën prej 20 për qind nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesi ka cekur se Vendimi i të Paditurës me të cilin refuzohet ankesa e tij është i pabazuar, sepse ai bazohet në faktin se librezat e tij e punës ishte mbyllur. Ankuesi ka cekur se është kthyer në punë në vitin 1999 dhe ka vazhduar punën me vite. Ai ka cekur se ka qenë gjithnjë i angazhuar në aktivitetet e NSH-së edhe pse nuk ka pasur punë për te. Ai thotë se nuk ka marrë vendim mbi ndërprerjen e punësimit, librezat e tij e punës është e hapur andaj edhe nuk është e drejtë që e Paditura e ka refuzuar kërkesën e tij në bazë të shënimeve të NSH-së mbi punësimin. Ai ka cekur se ka qenë në listën e pagave në vitin 2000. Kërkon nga DHPGJS që ta caktojë një seancë dëgjimore.

Në vërejtjet me shkrim të datës 31 maj 2011, e Paditura tregon se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse ankuesi nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për të qenë në listë. E Paditura thekson se sipas shënimeve të librit amzë të NSH-së dhe deklaratës së Drejtorit të NSH-së, ankuesi ka qenë i punësuar në NSH prej 01.07.1999 deri me 15.08. 2000 kur iu ka ndërprerë punësimi në bazë të asaj që ai kishte filluar një punë të re. E Paditura ka cekur se Ankuesi nuk ka prezantuar dokumente tjera në mbështetje të kërkesës së tij.

Me 29 prill 2011, R.H. (**ankuesi C10**) ka paraqitur ankesë duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfitur pjesën prej 20 për qind nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesi ka cekur se Vendimi i të Paditurës me të cilin refuzohet ankesa e tij është i pabazuar, sepse ai bazohet në faktin se librezat e tij e punës ishte mbyllur. Ankuesi ka cekur se është kthyer në punë në vitin 1999 dhe ka vazhduar punën me vite. Ai ka cekur se ka qenë gjithnjë i angazhuar në aktivitetet e NSH-së edhe pse nuk ka pasur punë për te. Ai thotë se nuk ka marrë vendim mbi ndërprerjen e punësimit, librezat e tij e punës është e hapur andaj edhe nuk është e drejtë që e Paditura e ka refuzuar kërkesën e tij në bazë të shënimeve të NSH-së mbi punësimin. Ai ka cekur se ka qenë në listën e pagave në vitin 2000. Kërkon nga DHPGJS që ta caktojë një seancë dëgjimore.

Në vërejtjet me shkrim të datës 31 maj 2011, e Paditura tregon se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse ankuesi nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për të qenë në listë. E Paditura thekson se sipas shënimeve të librit amzë të NSH-së dhe deklaratës së Drejtorit të NSH-së, ankuesi ka qenë i punësuar në NSH prej 01.07.1999 deri me 30.06. 2003 kur iu ka ndërprerë marrëdhënia e punës. E Paditura ka cekur se Ankuesi nuk ka prezantuar dokumente tjera në mbështetje të kërkesës së tij.

Me 29 prill 2011, Z.S. (**ankuesja C11**) ka paraqitur ankesë duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të përfitur pjesën prej 20 për qind nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Ankuesja ka cekur se Vendimi i të Paditurës i datës 26 janar 2011 me të cilin refuzohet ankesa e tij është i pabazuar. Ankuesja ka cekur se librezat e saj e punës është e hapur dhe se është kthyer në punë në vitin 1999 në NSH ku ka vazhduar punën me vite. Ajo ka cekur se ka qenë gjithnjë e angazhuar në aktivitetet e NSH-së edhe pse nuk ka pasur punë për të. Ai thotë se nuk ka marrë vendim mbi

ndërprerjen e punësimit, librezat e saj e punës është e hapur andaj edhe nuk është e drejtë që e Paditura e ka refuzuar kërkesën e saj në bazë të shënimeve të NSH-së mbi punësimin. Ajo ka cekur se ka qenë në listën e pagave në vitin 2000. Kërkon nga DHPGJS që ta caktojë një seancë dëgjimore.

Në vërejtjet me shkrim të datës 31 maj 2011, e Paditura tregon se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme sepse ankuesja nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për të qenë në listë. E Paditura thekson se sipas shënimeve të librit amzë të NSH-së dhe deklaratës së Drejtorit të NSH-së, ankuesja ka qenë e punësuar në NSH prej 01.07.1999 deri me 16.08. 2000 kur iu ka ndërprerë marrëdhënia e punës sepse kishte filluar punë të re me punëdhënësit tjetër. E Paditura ka cekur se Ankuesja nuk ka prezantuar dokumente tjera në mbështetje të kërkesës së saj.

Arsyetimi ligjor

Aktgjykimi lëshohet pa u mbajtur seancë dëgjimore sepse faktet dhe argumentet ligjore janë dorëzuar mjaftë qartë. Kolegji nuk pret informata tjera relevante dhe argumente në seancën dëgjimore (Neni 68.11 i shtojcës së Ligjit mbi Dhomën e Posaçme).

I

Pranueshmëria

Të gjitha ankesat e dërguara janë të pranueshme.

Ato janë dërguar brenda afatit sipas Nenit 67.6 të Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut Nr. 2008/6 lidhur me Nenin 10.6 (a0 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13.

Mos-kundërshtimi nga ana e ankueseve listën e përkohshme, në kuptim të Nenit 67.2 të Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut 2008/6, nuk e bën ankesën kundër listës përfundimtare të papranueshme.

- a. Neni 127 i Ligjit mbi Procedurën Administrative Nr. 02/L-28 nuk zbatohet.
Neni 127 përcakton

“ Ankesa administrative

127.1 Ankesa administrative mund të parashtrohet në formë të kërkesës për rishikim apo si ankesë.

127.2. Çdo palë e interesuar ka të drejtë në ankesë kundër një akti administrativ apo kundër refuzimit të paligjshëm për të lëshuar një akt administrativ.

127.3. Organi administrues të cilit i është drejtuar ankesa e rishqyrton ligjshmërinë dhe përputhshmërinë e aktit të kundërshtuar.

127.4. Palët e interesuara mund të drejtohen gjykatës vetëm pasi që janë shterur të gjitha mjetet administrative të ankesës.”

Udhëzimi Administrativ i UNMIK-ut 2008/6, në Nenin 70.3 (a) dhe (b) nën titullin Ligji i Zbatueshëm nuk i referohet Ligjit mbi Procedurën Administrative Nr. 02/L-28 por i referohet Ligjit të Procedurës Kontestimore i cili nuk përmban ndonjë dispozitë ku kërkohet shterimi i mjeteve administrative para shkuarjes në gjykatë.

Por, edhe po të zbatohet Neni 127 i Ligjit mbi Procedurën Administrative Nr. 02/L-28 Ankuesit nuk do të kishin nevojë ta kundërshtonin listën e përkohshme para se të ankohen kundër listës përfundimtare. Ankesa e tyre nuk i përket listës së përkohshme (e cila mund të kundërshtohet) por listës përfundimtare (kundër të cilës nuk është e mundur kurrfarë mjeti administrativ).

- b. Po ashtu, formulimi i Nenit 67.2, fjalia e parë, e Udhëzimit Administrativ 2008/6 nuk mund të interpretohet në at mënyrë që punëtori duhet patjetër të kundërshtoi listën e përkohshme në mënyrë që më vonë të ketë të drejtë të ankohet kundër listës përfundimtare. Neni 67.2, fjalia e parë, Udhëzimi Administrativ i UNMIK-ut 2008/6, përcakton:

“Pas pranimit të listës së punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën sipas nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit publikon një listë të përkohshme të punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën bashkë me një njoftim për publikun mbi të drejtën e çdo personi që brenda 20 ditësh të parashtojë ankesë në këtë agjenci për përfshirje në listë ose kundërshtimin e listës së punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën. “

Ligji e përcakton vetëm të drejtën për ta kundërshtuar listën e përkohshme, e nuk përcakton se kush nuk e kundërshton listën e përkohshme nuk mund ta kundërshtojë listën përfundimtare më vonë.

- c. Kolegji është në dijeni se obligimi për kundërshtimin e çfarëdo mungesë në listën e përkohshme e kombinuar me sanksionim, ashtu që nëse kjo nuk bëhet ankesa kundër listës përfundimtare bëhet e papranueshme do ti ndihmonte Agjencisë që për një kohë të shkurtë ta themelojë një listë të drejtë .

Procedura që së pari të përpilohet lista e përkohshme dhe tu epet mundësia çdokujt për ta kundërshtuar këtë listë dhe të dërgojë fakte dhe prova brenda 20 ditëve do ta ndihmonte AKP-në që pa vonesë ta themelonte listën përfundimtare të drejtë. Kjo ka për qëllim koncentrimin dhe përshejtimin e procedurës. Mbledhja e të gjitha fakteve të nevojshme dhe provave sa më parë që është e mundur është një aset thelbësor në kontekstin procedural në të cilin shumica monetare e pjesës prej 20% për secilin punëtor varet nga vendimi mbi pranimin apo refuzimin e ankesës së parashtruar.

Udhëzimi Administrativ i UNMIK-ut nr 2008/6 nuk e lejon sanksionimin mungesën e bashkëpunimit të Punëtorit në fazën e themelimit të listës përfundimtare, duke e bërë ankesën kundër listës përfundimtare si të papranueshme (krahaso: Aktgjykimet e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme SCEL -09-0001 dhe SCEL -10-0027)

Arsyetimi mbi bazat

Ankesat e Ankuesve janë të bazuara.

Neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/45 i paraqet kushtet që një punëtor të konsiderohet legjitim dhe neni 10 përcakton procedurën për paraqitje të ankesës në Dhomën e Posaçme si ën vijim:

“ 10.4 Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit ose inicimit të procedurës së likuidimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri (3) vite. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorët, të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qenë diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6”.

D.S. (Ankuesi C1) dhe J.S. (Ankuesja C2)

Të dy ankuesit kanë qenë jo më pak se tri vite në listën e pagave të NSH-së. Ligji nuk kërkon që periudha e të qenit në listën e pagave duhet patjetër të vazhdoi pa ndërprerje deri në privatizim. Kushti i parë për tri vite të të qenit në listën e pagave dhe kushti i dytë e të qenit punëtor në ditën e privatizimit mund të plotësohet ndaras nga njëri tjetri në kohë të ndryshme. Mirëpo, këta ankues në ditën e privatizimit me 27.12. 2006, nuk ishin më të regjistruar si punëtorë të NSH-së. Ata janë larguar nga Gjilani në qershor të vitit 1999, respektivisht pas qershorit 1999 për shkak të gjendjes kërcënuese për jetë dhe se të dytë ankohen se janë diskriminuar për shkak të etnisë Serbe. E paditura nuk e ka kontestuar këtë por vetëm ka treguar se të dytë nuk e kanë kundërshtuar listën e përkohshme të punëtorëve me të drejta legjitime. Mirëpo, siç ceket më lart, kjo nuk është arsye për ti përjashtuar ata nga lista përfundimtare. Në procedurën kontestimore jo-kontestimi nënkupton pranim. Gjykata nuk duhet dhe nuk do të në dyshim faktet e pakontestueshme. Ata të dy i kanë plotësuar kushtet e Nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/45. Ata do të kishin qenë punëtorë në kohën e privatizimit po të mos iknin nga diskriminimi i kërcënimit. Andaj, ata duhet pranohen për të qenë në listë (Aktgjykimet e DHPGJS-së, SCEL-09-0001 dhe SEL-10-0027).

M.S. (Ankuesi C3/1), N.S. (Ankuesi C3/2), M.P. (Ankuesi C3/3), D.S. (Ankuesi C4), I.L. (Ankuesi C5), M.M. (Ankuesja C8), N.M. (Ankuesi C9), R.H. (Ankuesi C10) dhe Z.S. (Ankuesja C11).

Lidhur me të gjithë këta ankues, e Paditura refuzon pranimin në listën përfundimtare mbi bazë të asaj se para datës së privatizimit atyre iu kishte ndërprerë marrëdhënien e punës përmes një njoftimi për ndërprerje. Por, këta ankues kanë deklaruar se nuk e kanë marrë kurrë këtë njoftim e po ashtu edhe e paditura nuk ka pohuar se ata e kaun pranuar këtë. Pa marrjen e njoftimit të tillë nga ana e ankuesve, kontrata e punësimit nuk iu ka përfunduar sepse Neni 90 të Ligjit të Punës së Serbisë së datës 10 korrik 1991, parasheh:

“Vendimi mbi pushimin nga puna i dërgohet punëtorit me shkrim. Ai veçmas duhet të përmbajë: bazat për pushim nga puna, një arsyetim dhe një shënim për këshillë ligjore dhe ët drejtat e punëtorit gjatë papunësisë së përkohshme”.

Kjo Rregullore është jo-diskriminues dhe për këtë arsye edhe zbatohet (Neni 3 i Rregullores së UNMIK-ut 1999/1, datë 15 korrik 1999 mbi Ligjet e Zbatueshëm në Kosovë. Por, edhe po të mos zbatohet, pushimi nga puna do të ishte i pavlefshëm sepse është parim i përgjithshëm se një akt ligjor i kryer me një deklaratë të vullnetit është e vlefshme vetëm nëse ajo deklaratë e vullnetit i është komunikuar palës tjetër. Kolegji duhet patjetër nuk duhet të vlerësoi se nëse ka qenë e drejtë e NSH-së për ti pushuar nga puna këta ankues për shkak të mungesës së gjatë nga puna. Supozojmë se ka qenë një e drejtë që nuk është shprehur në mënyrë valide. Pa u pushuar nga punë në mënyrë valide ata mund të mos kenë të drejtë të punojnë dhe fitojnë, por kontratat punës mbetet ekzistuese.

Kjo do të thotë se kur është bërë privatizimi këta ankues kanë qenë ende punëtorë të NSH-së. Pasi që nuk është kundërshtuar të qenit e tyre tri vite në listën e pagave, ata po ashtu duhet të pranohen në listën përfundimtare.

S.N. (Ankuesi 3/4) dhe B.S. (Ankuesi C3/5)

Gjithashtu, pranimi në listën e punëtorëve me të drejta legjitime nuk mund të mohohet as për këta dy ankues. Fakti se ata kanë paraqitur kërkesë për përfitime sociale nuk ka pasur efekt në kontratën e punës me NSH-në. Ata kurrë nuk janë pushuar nga puna në NSH në mënyrë të vlefshme.

Pasi që kushtet tjera për futje në listë nuk janë kundërshtuar, ata duhet pranuar.

M.S. (Ankuesi C3/6), K.J.A. (Ankuesi C6) dhe M.D.J. (Ankuesi C7)

E njëjta vlen edhe për këta ankues. Njoftimi për vendimin e datës 1.9.1999 nga bordi i NSH-së ku deklarohet se këta tre ankues (po ashtu edhe Ankuesi C3/2) janë pushuar nga puna nuk është deklaratë valide për pushim nga puna sepse ajo nuk u është dërguar personave në fjalë. Kushtet tjera për futje në listën e punëtorëve me të drejtat legjitime nuk janë kundërshtuar. Andaj, këta ankues gjithashtu duhet pranuar në listë.

Shpenzimet

Gjykata byk i cakton shpenzimet për ankuesit pasi që Presidiumi i gjykatës deri me tani nuk ka nxjerrë një plan me shkrim për tarifa që është miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (Neni 57, paragrafi 2 i Shtojcës së Ligjit mbi Dhomën e Posaçme) Kjo do të thotë se nuk ka baza të mjaftueshme ligjore për ngarkim me shpenzime.

Këshillë ligjore

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrahet Ankesë brenda 21 ditësh tek Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme. Ankesa duhet t'i dërgohet edhe palës tjetër dhe të dorëzohet tek Trupi Gjyqësor **nga Ankuesi** brenda 21 ditësh. Ankuesi duhet të dorëzojë tek Kolegji i Ankesave dëshminë se e ka dërguar Ankesën edhe tek pala tjetër.

Afati i paraparë fillon në mesnatën e asaj dite kur Ankuesit i është dërguar aktvendimi me shkrim.

Kolegji i Ankesave e refuzon ankesën si të papranueshme nëse Ankuesi nuk e parashtron atë brenda afatit të paraparë.

I Padituri mund të ushtrojë përgjigje tek Kolegji i Ankesave brenda 21 ditëve nga data kur i është dërguar ankesa, duke e dorëzuar përgjigjen edhe tek ankuesi dhe tek pala tjetër.

Ankuesi pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja në ankesën e tij, për ta dorëzuar përgjigjen e vet tek Kolegji i Ankesave dhe për ta dërguar atë tek pala tjetër. Pala tjetër pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja e ankuesit që të dorëzojë kundërpërgjigjen e tij tek Ankuesi dhe tek Kolegji i Ankesave.

Alfred Graf von Keyserlingk
Gjyqtar Kryesues